



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM SHKODËR

**UDHËZIM I PËRGJITHSHËM**

**NR. 13 , DATË 29.05.2023**

**“MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITYARE NË LUFTËN KUNDËR  
KRIMINALITETIT PËR VITIN 2023, NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË  
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR”.**

Në mbështetje të neneve 148, 148/b e vijues të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, si dhe në neneve 38, 42, 43, 46, 47, 48, 50, 103 e vijues të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 5, 7 e vijues të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neneve 24 dhe 25 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve priorityare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2023” dhe Udhëzimit të Përgjithshëm me nr.02, datë 12.05.2023, “Për rekomandimet priorityare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, të Prokurorit të Përgjithshëm.

**U D H Ë Z O J :**

- Të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe stafi administrativ i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër duhet të njihen dhe të zbatojnë rekomandimet priorityare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr.226, datë 13.04.2023 dhe Udhëzimin e Përgjithshëm me nr.02, datë 12.05.2023, “Për rekomandimet priorityare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Rekomandimet priorityare mund të aksesohen të plota në faqen e internetit “<https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/66/1a06dd52-f86c-455d-940c-7bb255f50aee;q=rekomandimet%20priorityare>.”
- Në punën e tyre gjatë vitit 2023, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore duhet të kenë në vëmendje dhe të zbatojnë prioritetet e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe realizimin e objektivave dhe forcimin e luftës kundër kriminalitetit gjatë këtij viti.
- Gjatë vitit 2023, duhet të respektohet detyrimi i dërgimit të informacionit periodik mbi zbatimin dhe ecurinë e Rekomandimeve Priorityare nga të gjithë prokurorët. Kjo sipas detyrimit ligjor çdo 3 muaj dhe sa herë që do të kërkohet nga Drejtoria e Koordinimit

Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme apo nga Drejtuesi i Prokurorisë, sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.226, datë 13.04.2023 dhe Udhëzimit të Përgjithshëm me nr.02, datë 12.05.2023, "Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe të këtij udhëzimi.

## **I. Në lidhje me masat administrative :**

- Në vijimësi duhet të merren masat e duhura, nga Drejtuesi i Prokurorisë, Drejtuesit e seksioneve, kryesekretaria, zyra e rregjistrimit për mbikëqyrjen teknike dhe administrative të sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve nëpërmjet kërkesave për informacion lidhur me mënyrën e disponimit për hedhjen e shortit elektronik nëpërmjet sistemit CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrollin e vazhdueshëm mbi hedhjen dhe administrimin e këtyre të dhënave.
- Duhet të merren masat e duhura në drejtim të rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht ato që lidhen me korrupsionin, trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, trafikimin e qenieve njerëzore, veprat penale kundër mjedisit, krimet kibernetike, etj.
- Të vijojnë masat në drejtim të mbikëqyrjes dhe përditësimit dhe plotëshmërisë së të dhënave për procedimet/çështjet e pastrimit të parave dhe procedimeve pasurore nëpërmjet sistemit elektronik e-tracking PRESTO si dhe të dhënave statistikore. Kjo me synim për të rritur numrin e procedimeve penale të rregjistruara, dërguara për gjykim dhe të dënimeve për veprat penale prioritare dhe sipas tipologjive të rekomanduara.
- Marrjen e masave për rritjen më tej të efijencës në bashkëpunimin ndërinstitucional për përmbushjen rekomandimeve të Moneyval-it dhe FATF-së, në kuadrin e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.10/2020 "Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave e krimeve financiare dhe financimin e terrorizmit, dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", i ndryshuar, si për të rritur më tej numrin e procedimeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim, dhe të dënuarve për veprat penale të pastrimit të parave, veçanërisht persona të tretë profesionistë dhe/ose subjekte raportuese (gatekeeper), ashtu dhe për rritjen më tej të hetimeve financiare e pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e pasurive produkte të veprimtarisë kriminale, ose vlerën ekuivalente, bazuar në prova/rrethana fakti objektive sipas ligjit.
- Rritjen e kontrollit dhe mbikqyerjes së veprimtarisë dhe të dhënave në sistemin elektronik (SVHOPGJP) për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori, për numrin e veprimeve hetimore që kryejnë për secilin procedim penal apo procedim/hetim pasuror, me synim administrimin e të dhënave dhe përfitim të statistikave periodike 15 ditore, me të dhëna për numrin e veprimeve hetimore apo ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale në kuadrin e procedimit penal ose për numrin e veprimeve verifikuese pasurore në kuadrin e procedimit pasuror, të kryera nga secili oficer i policisë gjyqësore sipas seksioneve.

## **II. Në lidhje me masat procedurale të përgjithshme :**

- Drejtuesi i prokurorisë do të koordinojë punën dhe detyrat me drejtuesit e seksioneve dhe në vijim me prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në lidhje me çdo kërkesë, sugjerim, shqetësim apo informacion që ata kanë në kuadër të veprave penale dhe procedimeve penale objekt i rekomandimeve prioritare në drejtim të vlerësimit nevojave dhe për marrjen e masave të duhura procedurale në kryerjen e hetimeve dhe ushtrimin e ndjekjes penale në përshtatje me gjendjen e treguesve të kriminalitetit dhe problematikat e evidentuara në vijimësi, si dhe për të lehtësuar dhe garantuar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me masat procedurale, duke respektuar pavarësinë e institucionit dhe garantuar pavarësinë e prokurorëve.
- Në vijimësi dhe në çdo rast që do të kërkohet nga prokurorët do të nxirren udhëzime të përgjithshme ose udhëzime të posacme jo të detyrueshme, me qëllim krijimin e lehtësirave dhe nxitjen e duhur kur do të vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit në hetimet paraprake ose në fazën e gjykimit, për vepra penale sipas kompetencës lëndore dhe në drejtimet prioritare të rekomanduara.
- Nga Drejtuesi i prokurorisë do të merren masat e duhura për të koordinuar veprimtarinë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete që lidhen me fushat/drejtimet prioritare të rekomanduara.
- Nga Drejtuesi i prokurorisë dhe/ose drejtuesit e seksioneve do të kërkohet informacion periodik apo sipas vlerësimit të nevojave me qëllim verifikimin e ecurisë/përfundimit të procedimeve, në hetimet paraprake ose në gjykim, për veprat penale prioritare të rekomanduara sipas ligjit dhe në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit, duke garantuar paanshmërinë dhe shmangien e çdo lloj influence apo ndikimi ndaj Prokurorit të çështjes, gjatë kryerjes së hetimeve apo gjatë shqyrtimit të çështjeve në gjykatë, në drejtimet prioritare të rekomanduara.
- Nga Drejtuesi i prokurorisë në bashkërendim me Drejtuesit e seksioneve dhe me zyrën e regjistratit do të vijojnë të merren masat e nevojshme administrative për monitorimin e përditësimit të sistemeve elektronike PRESTO dhe SVHOPGJP, si dhe të kërkojnë nga prokurorët apo personat (opgj apo nëpunës/sekretarë) e autorizuar prej tyre që në rakordim/koordinim me zyrën e regjistratit të pasqyrohen, pa vonesë, në regjistrat përkatës, të dhënat për ecurinë e procedimit/çështjes, sipas fazave të procedimit, dhe mbikëqyrin/kontrollojnë në vazhdimësi saktësinë e të dhënave të regjistruara, administruara, dhe para dërgimit në afat të të dhënave statistikore në Prokurorinë e Përgjithshme, me synim përmirësimin e koordinimit institucional në lidhje me administrimin dhe raportimin në kohë të të dhënave statistikore, që lidhen me progresin institucional të prokurorisë në procesin e integritetit të vendit në drejtimet prioritare të rekomanduara.

### **III. Në lidhje me masat procedurale nga prokurorët :**

- Drejtuesi i prokurorisë, në bashkëpunim dhe koordinim me prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe stafin administrativ, në vijimësi dhe periodikisht do të marrë masat e duhura në drejtim të marrjes dijeni në kohën sa më të shkurtër për veprat penale të kryera apo në proces nga burime të hapura, dhe jo vetëm, me iniciativën për fillimin kryesisht të procedimeve/hetimeve duke përfshirë rastet e ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të

jashtëm në veprimtarinë e prokurorit, verifikimin e ecurisë dhe përfundimin e çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, duke monitoruar në veçanti, respektimin e afateve procedurale, rritjen e efektivitetit dhe plotshmërisë së hetimeve, si dhe respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit penal dhe garantimin e procesit të rregullt ligjor.

- Në vijimësi, periodikisht dhe sa herë të kërkohet nga prokurorët apo do të vlerësohet e nevojshme do të zhvillohen mbledhje tematike me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve apo me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e Policisë së Gjyqësore të caktuar për ecurinë në kryerjen e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara.
- Në vijimësi gjatë vitit 2023, do të nxirren urdhëra dhe udhëzime për policinë gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve në kuadër të luftës kundër veprave penale prioritare të rekomanduara dhe ato të lidhura me to;
- Do të vijojnë të merren masat e duhura për të mbështetur punën e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve nëpërmjet menaxhimit të duhur të burimeve njerëzore dhe logjistike në dispozicion, si dhe për krijimin e ambjentëve të përshtatshme në prokurori në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur për të siguruar aksesin për persona me paafësi fizike dhe pritjen e publikut, sipas prioriteteve të rekomanduara;
- Do të vijojnë të merren masat e duhura në drejtim të bashkërendimit dhe koordinimit me efikasitet të veprimtarisë me prokuroritë e tjera, me iniciativë ose kur kërkohet, në drejtimet/fushat ose për veprat penale prioritare të rekomanduara;
- Në vijimësi duhet të bashkëpunojmë në mënyrë efektive me institucionet shtetërore dhe ato ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe të zhvillojmë analiza të përbashkëta ndërinstucionale sipas nevojave, jo më pak se një në çdo gjashtë muaj.
- Në koordinim me prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të kësaj prokurorie, do të organizohen seminare dhe trajnime të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe do merren masa për të lehtësuar pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në fushat dhe drejtimet e rekomanduara, veçanërisht në ato me fokus në luftën kundër korrupsionit, krimet e rënda dhe/ose trafikimet e paligjshme, krimeve financiare, krimet kibernetik, krimet zgjedhor, krimet mjedisor, veprat me natyrë gjinore, seksuale, diskriminuese dhe/ose me përfshirjen e të miturve, me fokus bazueshmërinë në ligj të hetimeve dhe vlefshmërinë e provave në hetimet financiare, evazionit fiskal dhe krimeve kibernetike.
- Gjatë vitit 2023, prokurorët duhet të vlerësojnë në çdo rast masat në rekomandimet prioritare për luftën ndaj kriminalitetit dhe/ose udhëzimet e nxjerra nga Drejtuesi i prokurorisë për të garantuar zbatimin e tyre, që ndihmojnë dhe/ose lehtësojnë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit sipas prioriteteve të rekomanduara, dhe duke ruajtur pavarësinë nga çdo ndikim të paligjshëm në vendimmarrjen e tyre, marrin masat procedurale të udhëzuara.

- Prokurorët duhet të tregohen sa më aktiv gjatë hetimeve paraprake sipas ligjit, në marrjen dijeni për vepra penale nga burime të hapura, me iniciativën e vet, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale prioritare të rekomanduara.
- Prokurorët duhet të kryejnë hetime të plota e të gjithanshme për veprat penale dhe/ose ndaj subjekteve për veprat penale prioritare të rekomanduara, në bashkërendim me Prokurorinë e Posaçme sipas ligjit dhe aktit të kordinimin ndërinstitucional, duke rritur më tej treguesit/rastet e hetime proaktive efektive, përdorimin e metodave speciale të hetimit sipas ligjit, dhe hetimet financiare paralele ose procedimet pasurore, si mjete për kërkimin e provave dhe për sekuestrimin/konfiskimin e pasurive/aseteve produkte të veprave penale ose veprimtarive kriminale prioritare të rekomanduara.
- Prokurorët duhet të vlerësojnë dhe të konsiderojnë ekzistencën e kushteve/kritereve ligjore për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në zbatim të nenit 37/a të Kodit të Procedurës Penale, duke synuar vënien përpara përgjegjësisë të çdo bashkëpunëtori në veprimtarinë kriminale, me synim për të parandaluar dhe riparuar dëmet e shkaktuara për veprat penale prioritare të rekomanduara.
- Prokurorët duhet të përdorin me efikasitet bazat e të dhënave të institucioneve ligjzbatuese të tjera ku prokuroria ka akses për rritjen e efektivitetit të hetimeve;
- Prokurorët duhet të synojnë në kryerjen e analizave të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve policore në strukturat hetimore përkatëse dhe/ose të agjencive ligjzbatuese, për rastet e referuara, shkëmbimin dhe kërkimin e ekspertizës në funksion të përmirësimit të shpejtësisë e gjithanshmërisë në ecurinë e hetimeve të specializuara ndaj subjekteve përkatës për veprat penale prioritare të rekomanduara;
- Prokurorët duhet të tregojnë kujdes të shtuar në ruajtjen e sekretit të hetimit dhe ndalimin e publikimit të akteve, duke konsideruar veçanërisht mundësinë e përfshirjes së punonjësve shtetërorë si bashkëpunëtorëve të "*jashtëm ose brendshëm*" në luftën kundër krimeve të rënda, korrupsionit dhe veprave të tjera prioritare të rekomanduara.
- Secili prokuror duhet të marrë masat e duhura për të siguruar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm sipas fushave/drejtimeve prioritare të rekomanduara dhe akteve/marrëveshjeve të përbashkëta ndërinstitucionale të rekomanduara që unifikojnë dhe lehtësojnë koordinimin dhe bashkërendimin me strukturat/institucionet në fushat përkatëse të rekomanduara.
- Prokurorët duhet të tregojnë kujdes për zbatimin efektiv të të drejtave procedurale të të pandehurve/personave nën hetim apo të dyshuarve dhe sigurimin e drejtësisë miqësore për të miturin në konflikt me ligjin, si dhe garantojnë trajtimin me respekt për dinjitetin njerëzor dhe mbrojtjen nga ridëmtimi, riviktimizimi dhe viktimizimi i dytë, të viktimave të veprave penale gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre në proces;
- Gjatë ushtrimit të detyrës prokurorët duhet të ndjekin një politikë penale eficiente, me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimeve prioritare të rekomanduara, ashtu dhe për parandalimin e posaçëm dhe të përgjithshëm të veprave penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht, duke analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në

aktet/kërkesat/konkluzionet procedurale, si rrethanat e faktit të bazuara në prova, ashtu dhe kushtet/kriteret ligjore, në këto drejtime:

- ✓ Në drejtim të **ashpërsimit të kërkesave** për masat e sigurimit dhe caktimin e llojit dhe masës së dënimit për veprat penale në fushën e narkotikëve dhe trafiqeve të paligjshme, krimit në familje ose për shkak të marrëdhënieve familjare, veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe vepra penale të tjera të rekomanduara;
- ✓ Në drejtim të **aplikimit të masave alternative të shmangies** ndaj të miturve në konflikt me ligjin sipas rekomandimeve prioritare;
- ✓ Në drejtim të **aplikimit të dënimeve alternative** në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, personave vulnerabël ose personave me problem serioze shëndetësore sipas rekomandimeve prioritare;
- ✓ Në drejtim të **rritjes më tej të numrit të procedimeve**, të pandehurve të dërguar për gjykim, dhe të dënuarve për veprat penale të pastrimit të parave, veçanërisht persona të tretë profesionistë dhe/ose subjekte raportuese (gatekeeper), ashtu dhe për rritjen më tej të hetimeve financiare ose pasurore paralele për identifikimin, sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e pasurive produkte të veprimtarisë kriminale, ose vlerën ekuivalente, bazuar në prova/rrethana fakti objektive sipas ligjit, etj:
- Prokurorët duhet të synojnë në rritjen e numrit të kërkesave për **gjykim të drejtpërdrejtë** dhe për rritjen e numrit të kërkesave në zbatimin e instituteve procedurale penale të **gjyqimit me marrëveshje** dhe **urdhrit penal**, duke vlerësuar kushtet dhe kriteret ligjore dhe synimet prioritare të rekomanduara;
- Prokurorët gjatë vitit 2023, duhet të synojnë në drejtim të rritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve dhe aftësive profesionale të tyre, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime apo në tryeza diskutimesh, si dhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të strukturave hetimore në shërbimet, veçanërisht në ato me fokus në luftën kundër korrupsionit, krimet e rënda dhe/ose trafikimet e paligjshme, krimeve financiare, krimit kibernetik, krimit zgjedhor, krimit mjedisor, veprat me natyrë gjinore, seksuale, diskriminuese dhe/ose me përfshirjen e të miturve, me në qendër bazueshmërinë në ligj të hetimeve dhe vlefshmërinë e provave në hetimet financiare, evazionit fiskal dhe krimeve kibernetike.

#### **IV. Masat në marrëdhënie me policinë gjyqësore :**

- Secili prokuror duhet të vlerësojë në çdo rast kur është e mundur zbatimin e parimit të specializimit dhe urdhëron për kryerjen e hetimeve paraprake oficerët e policisë gjyqësore të strukturës hetimore përkatëse që ka referuar veprën penale në prokurori.
- Në raste të veçanta, me kërkesë të arsyetuar të secilit prokuror, me qëllim për të garantuar objektivitetin e hetimit, Drejtuesi i Prokurorisë mund të urdhërojë për kryerjen e hetimeve oficerët e policisë gjyqësore të strukturave hetimore përkatëse të shërbimeve të tjera ose të seksioneve të policisë gjyqësore në juridiksion.

- Prokurorët duhet të synojnë në shtimin e rasteve të kryerjes së veprimeve hetimore të përbashkëta nga oficerë të policisë gjyqësore në strukturat hetimore të shërbimeve me ato të seksioneve në prokurori, sipas prioriteteve të rekomanduara, bazuar edhe në kompleksitetin e çështjes për vepra penale prioritare të rekomanduara.
- Prokurorët duhet të ushtrojnë sistematikisht kontroll efektiv ndaj oficerëve të policisë gjyqësore në ecurinë e hetimit të procedimeve në ndjekje për ligjshmërinë, objektivitetin, plotshmërinë dhe respektimin e afateve në veprimet hetimore të kryera dhe/ose vlefshmërinë e akteve procedurale të përfutuara, në drejtimet prioritare të rekomanduara.
- Drejtuesi i Prokurorisë, në koordinim me Drejtuesit e Seksioneve dhe me prokurorët do të bashkërendojnë dhe mbikëqyerin veprimtarinë e policisë gjyqësore dhe në rast evidentimi të akteve dhe sjelljeve që përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit, si dhe sipas rastit duhet të kërkojnë dhe iniciojnë fillimin e procedimit disiplinor sipas ligjit.

#### **V. Masat në lidhje me përgjegjësinë disiplinore dhe për zbatimin e udhëzimit;**

- Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm, në udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit dhe/ose shkak për njoftimin dhe nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj oficerit të policisë gjyqësore dhe Prokurorit, Drejtuesit të Seksionit, sipas ligjit.
- Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët, drejtuesit e seksioneve dhe oficerët e policisë gjyqësore në strukturat hetimore të shërbimeve dhe të seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohen Drejtuesit e Seksioneve, të cilët për ecurinë e zbatimit të këtij udhëzimi dhe rekomandimeve prioritare informojnë periodikisht Drejtuesin e Prokurorisë.
- Udhëzimi i përgjithshëm nr.48, datë 12.09.2022 «Mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022», shfuqizohet.
- Me këtë udhëzim dhe për zbatimin e tij të njihen të gjithë Prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe stafi administrativ i Prokurorisë.
- Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**ALBERT MURÇAJ**

The stamp is circular and contains the following text: "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top, "PROKURORIA PRANË GJYKATËS" on the left, "SHKALLËS SË PARË" on the right, and "SHKODËR" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.